



Pranuar / Dorëzuar Punëdhënës / Proradato Received / Delivered	22 - 08 2022	2 viti god. years	
Organ / Njësia Organ / Jednitsa Org. / Unit	Nr. Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHKX	4869/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 132/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1121/2020 të datës 20.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.132/2020, të datës 21.04.2020, së ankuesit të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat me adrese banimi në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 132/2020 e datës 21.04.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 21.04.2020 me numër protokolli 768/2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore kundër Vendimi të datës 20.02.2020, të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.06.2020, me numër protokolli 1026/2022, përfaqësuesin e ankuesit se nuk mund të shqyrton dhe vendos lidhur

me ankesën A. nr.132/2020 të datës 04.06.2020 w ankuesit për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi pakënaqur me njoftimin e datës 04.06.2020, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 20.07.2022, A. Nr. 1121/2020, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 04.06.2020, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr.132/2022, të datës 21.04.2020 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova; Ankesën A. Nr. 132/2020 e datës 21.04.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi i datës 20.07.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi i datës 20.02.2020, i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi i datës 11.07.2019, e numër protokollit 322/2019, i Zëvendës Kryeministrit të parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme; e- maili i datës 02.05.2019; e- maili i datës 31.05.2019; Përgjigje në ankese e datës 23.03.2020; Ankesa e datës 06.03.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 04.07.2019; e- maili i datës 09.08.2022; Përgjigje në ankese e datës 04.06.2020, me numër protokollit 1022/2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimit ankimore të ankuesit

Kolegji ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit.

Ministria e Punëve të Jashtme ka shpall konkurs për Zyrtar të Misionit Diplomatik, ndërsa më datë 04.07.2019 përmes emailit nga Zyra e Personelit e Ministrisë së Punëve të Jashtme ankuesi është njoftuar që nuk ka arritur të kualifikohet për këtë pozitë, mirëpo në bazë të Vendimit me Nr. 322/2010 të datës 11.07.2019 të Zëvendëskryeministrit të parë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme është emëruar konsull në Misionin Diplomatik të Republikës së Kosovës në Kanberra/Australi me fillim nga data 01.08.2019, ndërsa sipas Vendimit me Nr. Ref:51/2020 të datës 20.02.2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme edhe shfuqizuar Vendimin me Nr. 322/2029 i datës 11.07.2019.

Ankuesi kundër këtij vendimi më datë 06.03.2022 ka parashtruar ankese në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, përmes përgjigjes së datës 23.03.2022 ka njoftuar që ky komision nuk ka mandat të shqyrtoj ankese pasi që emërimi është politik dhe sepse nuk është përzgjedhur sipas konkursit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me Nr. Ref:51/2020 i datës 20.02.2020 i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme është i kundërligjshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës, konstaton se ankuesi më datë 04.07.2019 përmes emailit nga Zyra e Personelit e Ministrisë së Punëve të Jashtme është njoftuar që nuk ka arritur të kualifikohet për këtë pozitë Zyrtar të Misionit Diplomatik, ndërsa si rezultat i kësaj nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi kundër këtij njoftimi apo procedurës së rekrutimit për Zyrtar të Misionit Diplomatik ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, konkretisht Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës sipas të cilit me nenin 81 është përcaktuar se: *"1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"*, ndërlidhur me këtë, nenin 4 paragrafi 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se: *"Të drejtë ankesë në Komision kanë edhe personat të cilët kanë konkurruar në procedurë të rregullt për rekrutim në Shërbimin Civil"*.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankuesit në mision diplomatik, përkatësisht neni 3 paragrafi 4, ka përcaktuar se: *"Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi"*, si dhe neni 8 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar se: *"Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës"*, andaj duke ju referuar këtyre dispozitave, dhe duke marrë për bazë faktin që ankuesi në mision diplomatik nuk është emëruar sipas procedurave të konkursit por i njëjti është emëruar në shërbimin e jashtëm me vendim të Zëvendëskryeministrit të parë dhe Ministrit të Punëve të Jashtme respektivisht me Vendimin me Nr. 322/2019 të datës 11.07.2019, atëherë nuk është dëshmuar me asnjë provë që ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune në shërbimin civil të Republikës së Kosovës përmes procedurave të konkursit sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është përcaktuar që Këshilli, shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, kështu që Këshilli

i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 132/2020

Avdyl BEKTESHI



Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

